



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike
Mbledhja nr. 36
Prishtinë, më 19.12.2018, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Vjosa Osmani-Sadriu, Time Kadrijaj, Danush Ademi, Glauk Konjufca, Fitore Pacolli, Elmi Reçica dhe Evgjëni Thaçi-Dragusha.

Munguan: Dukagjin Gorani, Doruntinë Maloku-Kastrati, Sërgjan Mitroviq dhe Zafir Berisha.

Pjesëmarrës nga MPJ: Behgjet Pacolli, zëvendëskryeministër dhe ministër i punëve të jashtme me bashkëpunëtorët: Muhamet Brajshori, Ariana Hoxha, Florent Muçaj, Fitim Sadiku, Rejhan Vuniqi, Prindon Sadriu dhe Jetlir Zyberaj.

Stafi mbështetës i Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Raportim i fundvitit i z. Behgjet Pacolli, ministër i Ministrisë së Punëve të Jashtme, në lidhje me fushëveprimtarinë e MPJ-së;
3. Të ndryshme.

1. Miratim i rendit të ditës;

Kryetarja konstatoi se komisioni miratoi rendin e ditës.

2. Raportim i fundvitit i z. Behgjet Pacolli, ministër i Ministrisë së Punëve të Jashtme, në lidhje me fushëveprimtarinë e MPJ-së;

Vjosa Osmani – Sadriu, tha se në lidhje me raportimin e ministrit Pacolli, duke pasur parasysh se anëtarëve të komisionit iu është dorëzuar një raport me shkrim, kërkoi që fillimisht nga ministri të bëhet një përmbledhje e temave, si përshkrim i shkurtër i aktiviteteve nga ky raport.

Behgjet Pacolli, bëri të ditur se nuk i ka ikur përgjegjësisë për të raportuar në komision, duke i njoftuar anëtarët e komisionit lidhur me angazhimet e tij jashtë vendit.

Vjosa Osmani-Sadriu, tha se komisioni ka qenë shumë mirëkuptues karshi angazhimeve të ministrit, porse zhvillimet në politikën e jashtme kanë qenë të jashtëzakonshme dhe tepër shqetësuese, sa i përket çështjes së anëtarësimit të Kosovës në Interpol, rezultatit të takimeve në Asamblenë e Përgjithshme si dhe lidhur me deklaratimet shqetësuese të MPJ të Serbisë, rreth tërheqjes së njohjeve të Kosovës. Për këto tema që konsiderohen të jashtëzakonshme, tha se kemi kërkuar që të vini më shpesh në raportim në komision. Gjashtë muaj pas takimit të fundit, janë grumbulluar tema, dhe në mënyrë që bashkëpunimi të jetë më substancial, është kërkuar nga komisioni që të jetë pjesë e grupit punues të MPJ-së për Këshillin e Evropës, për hartimin e Strategjisë si dhe të merr pjesë në grupet e tjera punuese të ministrisë.

Protokolli i shtetit, thuajse asnjëherë nuk e përfshinë komisionin në takimet e vizitave nga jashtë, e as kur akreditohen ambasadorët, e po ashtu, se ka raporte të ambasadorëve që vijnë në ministri, e të cilat kanë elemente që mund ta involvojnë komisionin. Mungojnë informatat për angazhimin e rrjetit për shërbimin e jashtëm të Kosovës, për krijimin e grupeve të miqësisë dhe shtoi se komisionit nuk i është përcjellë dokumenti për planin e rotacionit.

Në lidhje me shkresën drejtuar kryeparlamentarit për të kërkuar angazhim të grupeve të deputetëve në gjeografi për vende të caktuara, tha se do të ishte pro bashkëpunimit, nëse me një letër e tillë do të njoftoheshin edhe komisionet e nevojshme.

Behgjet Pacolli, njoftoi se ka pasur rreth 4 vizita në Afrikë, për të cilat opinion publik nuk e di për shkak të strategjisë së MPJ-së. Republika e Kosovës ka pasur 116 njohje të dëshmuara me nota verbale sipas konventave ndërkombëtare për njohjet. Pacolli bëri të ditur se shtetet e Komonueltit nuk dërgojnë nota verbale por bëjnë hapjen e kanaleve diplomatike dhe zyrave ndërlidhëse të përfaqësive diplomatike. Shteti i Nigerisë dhe ai i Ugandës, tha se kanë dërguar nota verbale të nënshkruara nga presidentët e tyre për njohjen e shtetit të Kosovës. Njohja nga Uganda tha se asnjëherë nuk është jetësuar për shkak të ndikimit të madh të Serbisë, në MPJ të Ugandës. Jetësimi i njohjes nga Nigeria pas vdekjes së ish- ministrit të jashtëm të tyre, tha se është në proces e sipër. Nigeria e ka mbështetur gjithnjë Kosovën dhe vota e saj ishte pro Kosovës, për anëtarësim në Interpol, ndërsa Uganda votoi kundër anëtarësimit tonë në Interpol. Ai tha se si rezultat i vizitave të tij në Zambia dhe Zimbabve, dy shtete nën ndikimin rus, në momentin e votimit për anëtarësim në Interpol, e kanë lëshuar sallën dhe se tani janë duke punuar me këto shtete.

Z. Pacolli njoftoi se janë duke punuar me shtetin e Mozambikut, i cili ka votuar kundër anëtarësimit të Kosovës në Interpol, ndërsa Kenia tha se është duke e shqyrtuar me kujdes njohjen e Kosovës. Shtete e Afrikës të cilat ende nuk e kanë njohur Kosovën, janë Etiopia, dy Kongot, Kenia e Afrika e Jugut, tek të cilat ka një ndalje, për shkak të ndikimit sipërfaqësor ekonomik kinez dhe të ndikimit rus, në lidhje me eksportin e armëve. Këto shtete nëse e njohin

Kosovën, konsiderohen se e ndërrojnë pozicionin dhe mund tu ndalen ndihma nga shtete e tjera. Sa i përket tërheqjes së njohjeve, tha se asnjë notë verbale deri sot, pos Ujdhesës Solomon nuk kanë pasur ku thuhet se e tërheqin njohjen e Kosovës. Është përfolur se një ministër apo kryeministër i Guineja Bisaos në Beograd ka deklaruar para mediave se nuk e di se kur është njohur Kosova nga shteti i tij.

Më tej z. Pacolli njoftoi se lidhur me këtë, ka pasur takim me presidentin e Guineja Bisaos dhe se ky pjesëtar i qeverisë është ndërruar nga posti dhe si rezultat i kësaj ka ardhur deri te krijimi i marrëdhënieve diplomatike mes dy vendeve. Z. Pacolli njoftoi edhe për shtetin e Libërisë, për të cilin tha se nuk e kanë tërheq njohjen, kanë arrit memorandum për marrëdhënie diplomatike dhe kanë bërë kërkesë që të pranohen kredencialet e ambasadorit tonë në Libëri. Lesoto, tha se nuk e ka tërheq njohjen e as nuk e ka ndryshuar pozicionin ndaj Kosovës, por ka votuar kundër për anëtarësimin në Interpol, për shkak të ndikimit rus që kanë dhe ndihmës humanitare që i kanë dhënë. Po ashtu, Burundi nuk e ka tërhequr njohjen e as Madagaskari, por e ka nënshkruar një memorandum me Serbinë, se nuk do të interferojnë në marrëdhëniet e dy shteteve deri tek rezultati i dialogut dhe po ashtu nga shteti Papa Guineja e Re, nuk ka rritur asnjë letër apo shkresë.

Pacolli theksoi se dialogu ka ndikuar nëpër vendet e ndryshme dhe se serbet janë duke u thirrur në Rezolutën 1244, në lidhje me dialogun. As nga Surinami, tha se nuk kanë marrë kurrfarë shkrese për tërheqje të njohjes.

Ministri theksoi se pos shkresës nga Ujdhesa Solomon, nuk kanë marrë asnjë letër tjetër dhe se tërheqja e njohjeve nuk ekziston as sipas konventave ndërkombëtare.

Vjosa Osmani-Sadriu, theksoi se ka çakordim në mes të qëndrimeve të aktorëve të politikës së jashtme, z. Hoxhaj ka konfirmuar se ka tërheqje të njohjeve e po ashtu, edhe zv. drejtori në MPJ z. Kiçmari e ka konfirmuar të njëjtën. Njohja tha se është akt i vullnetit politik dhe mund të ndryshojë varësisht nga ndryshimet në qeveri, ndërsa çështje tjetër është ajo e marrëdhënieve diplomatike.

Ajo e pyeti ministrin se pse është ky çakordim rreth tërheqjes së njohjeve dhe se a ka Kosova plan konkret strategjik se si t'i qaset këtyre 11 shteteve, se me cilët partnerë janë duke punuar, e po ashtu, se me cilët partnerë janë duke bashkëpunuar për t'i parandaluar shtete e tjera me të cilët Serbia po punon që t'ua ndryshojë qëndrimet karshi Kosovës.

Ajo më tej tha se i vjen mirë që ministri e konfirmoi se Serbia është duke e përdorur procesin e dialogut për t'i bindur shtetet për të tërhequr apo ngrirë njohjet e Kosovës, kinse dialogu qenka për përcaktimin final të statusit të Kosovës. Znj. Osmani pyeti ministrin se a i është dërguar ndonjë non-paper shteteve, se në radhë të parë ne bazoheni në opinionin e GJND-së dhe se Rezoluta 1244 përfundon në ditën e përcaktimit të statusit final të Kosovës, e nëse po a mund t'i ndajnë ato me komisionin.

Behgjet Pacolli, njoftoi se MPJ-ja të gjitha shteteve ju ka dërguar ribotimin e librit të GJND-së me notë verbale, ku është thënë se shpallja e pavarësinë së Kosovës është bërë në mënyrë të koordinuar me bashkësinë ndërkombëtare. Ai, po ashtu, tha se janë të njoftuar për lëvizjet e diplomacisë serbe dhe keqpërdorimet e tyre. Deklaratën e z. Kiçmarit e quajti tërësisht personale, ndërsa lidhur me deklaratën e z. Hoxhaj, tha se nëse ka pasur tërheqje të njohjeve, ai e din më mirë, porse deri më tani nuk e ka njoftuar ministrin Pacolli.

Pacolli theksoi se janë duke punuar që të koordinohen me aleatët që të jetë mbështetja edhe më e madhe për Kosovën.

Elmi Reçica, në lidhje me opinionet e ndryshme rreth tërheqjes së njohjeve, tha se edhe z. Hoxhaj edhe z. Kiçmari kanë thënë se ka tërheqje të njohjeve, por jo për shumë shtete. Ministri Pacolli deklaroi për një tërheqje, edhe të lartpërmendurit kanë menduar për tërheqjen e Ishullit Solomon e jo për diç më tepër, tha z. Reçica.

Behgjet Pacolli, rreth tërheqjes së njohjeve sipas deklaratës së z. Hoxhaj, tha se do t'i njoftojë anëtarët e komisionit me shkrim, pas konsultimeve që do ti bëj me të dhe bëri të ditur po ashtu, se ka një deklaratë të Departamentit të Shtetit Amerikan se Ishujt Solomon e kanë tërheqë notën verbale, mbi tërheqjen e njohjeve.

Fitore Pacolli, duke u ndërlidhur me diskutimet e ministrit, e pyeti atë se në çfarë mënyre janë marrë njohjet për Kosovën. Ndërsa lidhur me atë se Serbia ka informata për disa shtete se e kanë tërhequr njohjen e Kosovës, theksoi se me një shtet i cili e njeh Kosovën duhet të lidhen drejtpërdrejt marrëdhëniet bilaterale, ndërsa pyeti nëse kanë ndodh kontakte të drejtpërdrejta me këto shtete dhe si, e po ashtu pse nuk është shpërndarë informata mbi GJND-në më herët.

Behgjet Pacolli, theksoi se informata mbi GJND-në është dërguar me kohë. Ai njoftoi edhe për mënyrën e kontaktit me shtete njohëse të Kosovës, konkretisht për takimin me përfaqësues të shtetit të Gandit dhe marrëveshjet e biseduara atje. Z. Pacolli tha se nuk ka mund të shkojë në Papa Guinenë e Re, por ka planifikuar të shkojë ndërsa shtetet e tjera i ka vizituar dhe janë në mënyrë sistematike duke u vizituar. Sa i përket mënyrës së njohjes së Kosovës, tha se ka ndodh një gjë e drejtë dhe në harmoni me të drejtën ndërkombëtare.

Fitore Pacolli, pyeti ministrin Behgjet Pacolli, se sa ka ndikuar në tërheqjen e njohjeve deklarata e tij se në mes të Kosovës e Serbisë, nuk duhet të ketë kufij.

Behgjet Pacolli, tha se nuk beson se perspektiva e Kosovës do të jetë ndryshe veç se një ditë do të jetë pjesë e shtëpisë së madhe dhe do të kemi lëvizje të lirë dhe kufi të hapur.

Glauk Konjufca, theksoi se një fondacion i njohur ka bërë një analizë hulumtuese sa i përket njohjeve dhe tërheqjes së tyre. Në këtë drejtim, pyeti ministrin Pacolli se a ka pasur njohje nga Surinami dhe a e kanë tërhequr njohjen, kurse në vazhdim pyeti edhe për Liberinë, Papa Guinenë e Re, Republikën Dominikane, Solongo di Santis. Tërheqja e njohjeve, tha se duhet të shqyrtohen brenda Qeverisë sepse ka pasur edhe zyrtarë ndërkombëtarë që kanë diskutuar në lidhje me tërheqjen e njohjeve.

Behgjet Pacolli, njoftoi se Kosova ka pasur njohje nga Surinami, ndërsa nuk kanë marrë asnjë dokument për tërheqje të njohjes nga ai. Liberia, tha se nuk ka ndryshim të pozicionit të saj ndaj Kosovës. Z. Pacolli më tej njoftoi se nuk ka ndonjë dokument mbi tërheqje të njohjes as nga Papa Guineja e Re, as nga Republika Dominikane e as nga Solongo di Santis dhe ftoi ambasadorin e Britanisë që të ofrojë informata të tjera mbi tërheqje, nëse ai i ka.

Elmi Reçisa, tha se politika e jashtme duhet të jetë unike dhe atë ta mbështesim e në kuadër të saj të kemi aktivitete. Ai pyeti ministrin se çfarë hapa janë duke u ndërmarrë në kuadër të pesë vendeve të BE-së që nuk e kanë njohur Kosovën, e që po pengojnë në rrugëtimin tonë drejt BE-

së. Z. Reçica, sa i përket diplomacisë parlamentare, kërkoi që mundësisht shërbimi i jashtëm të angazhohet, për të krijuar grupe të miqësisë me këto pesë vende.

Behgjet Pacolli, bëri të ditur se janë duke u munduar të krijojnë një kanal komunikimi me Spanjën, në Greqi janë duke e hapur zyrën përfaqësuese ndërlidhëse të Kosovës, me Qipron, tha se janë duke punuar. Me Rumaninë, njoftoi se ka kanale të mira të komunikimit, me Sllovakinë, se janë në proces të hapjes së zyrës e po ashtu, njoftoi se me Vatikanin kemi raporte të mira.

Z. Pacolli theksoi se shteti i veriut është duke zhvilluar një fushatë shumë intensive parlamentare, se kanë publikuar një libër Titoja dhe Afrika, të cilën e përdorin në vendet që i vizitojnë. Kuvendi i Kosovës duhet të përgatitet që viti i ardhshëm të jetë një vit i punës, të ndahet në grupe dhe të vizitohet disa shtete, në bashkëpunim me MPJ-në për logjistikën.

Vjosa Osmani- Sadriu, theksoi se KPJDI por edhe Kuvendi në përgjithësi ka realizuar vizita të shumta në pesë vendet jo njohëse të BE-së, përveç Qipros, përmes një projekti, ku janë bashkëdyzuar veprimet me parlamentarë e shoqërinë civile. Këto çështje, tha se do të mund t'i diskutojmë me rastin e hartimit të Strategjisë për diplomacinë parlamentare.

Sa i përket logjistikës, MPJ-ja, tha se e ka ma lehtë të realizojë vizita sepse mbi 80% e deputetëve nuk posedojnë viza, e po ashtu, për shkak të procedurave administrative, kërkesat për realizimin e vizitave të deputetëve ndonjëherë zgjasin edhe nga dy muaj.

Z. Osmani theksoi se me rastin e vizitave jashtë vendit, disa ambasada tona bashkëpunojnë e disa të tjera nuk ndihmojnë, duke cekur se diplomacia parlamentare duhet të ndihmohet nga MPJ-ja në aspektin logjistik, që të jetë më efektive.

Time Kadrijaj, tha se procesi i tërheqjes së njohjeve ka qenë shqetësues për të gjithë dhe falënderoi ministrin për angazhimin që po bëhet në këtë drejtim. Kërkoi angazhim maksimal të shërbimit të jashtëm të Kosovës, që çështja e çnjohjeve të mbahet në kontroll, të jenë në nivelin e detyrave të tyre dhe para nesh këtu t'i kenë informatat për zhvillimet.

Evgjeni Thaçi- Dragusha, kërkoi nga ministri se a mund të konstatojë se tani për tani nuk kemi asnjë tërheqje të njohjeve. Ajo, po ashtu kërkoi të njoftohet nga ministri, në lidhje me zhvillimet diplomatike që kanë ndodhur ndërkohë me Poloninë dhe ambasadorin, i cili do të akreditohet në të ardhmen atje.

Behgjet Pacolli, tha se ne nuk kemi asnjë shkresë prej asnjë shteti, përveç nga Ishujt Solomon për pushimin e marrëdhënieve me Kosovën, deri në përfundim të dialogut me Serbinë, ndërsa Serbia spekulon për 59 tërheqje të njohjeve. Sa i përket Polonisë, ministri tha se jemi duke punuar në mënyrë sistematike, kemi marrëdhënie të mira dhe vota e tyre në Interpol, ishte pro Kosovës. Ai njoftoi se është kërkuar hapja e ambasadës në Poloni dhe tani për tani mendohet për ambasador jorezident në Poloni.

Vjosa Osmani- Sadriu, tha se përkundër asaj që ende nuk kemi marrë konfirmim nga Polonia për hapje të ambasadës, presidenti ka lëshuar një dekret që nuk duhet të lëshohet pa e marrë pajtimin.

Behgjet Pacolli, tha se dekreti nuk është lëshuar, ekziston në MPJ, dhe pritet që së shpejti të kemi zgjidhje finale sa i përket ambasadës. Pacolli njoftoi se janë duke punuar me Japoninë dhe Korenë e Jugut në mënyrë sistematike. Ai propozoi që Komisioni sa më shpejtë të vizitojë Ganën, një shtet interesant, meqë ka dëgjuar se shefja e parlamentit të tyre ka deklaruar se Kosova nuk ka aktivitete parlamentare me ta. Po ashtu, theksoi se janë edhe pesë shtete të Komonueltit, të cilat është me interes që të vizitohen.

Vjosa Osmani-Sadriu, theksoi se ka informata se edhe Uganda ka shprehë gatishmërinë për bashkëpunim ndërparlamentar dhe kërkoi që për shtetet që shprehin gatishmërinë për bashkëpunim ndërparlamentar, të njoftohet komisioni zyrtarisht që të fillohen procedurat. Sa i përket formimit të ekipeve për vizitë, tha se kjo është detyrë e Komisionit sipas Rregullores së Kuvendit.

Time Kadrijaj, në lidhje me realizimin e vizitave, tha se këto mund të realizohen në bashkëpunim me MPJ-në dhe një delegacioni të Komisionit.

Behgjet Pacolli, kërkoi që çështja e Interpolit të diskutohet me dyer të mbyllura.

Vjosa Osmani-Sadriu, lidhur me raportimin për Interpolin, theksoi se nëse janë çështje të përgjithshme që mund të ndahen me publikun e që nuk e dëmtojnë interesin e Kosovës, është mirë të thuhet ndërsa nëse ka çështje të veçanta, ato mund të trajtohen pasi të largohen mediat. Ajo bëri të ditur se për tema të ndjeshme komisioni mund të mbajë takim të mbyllur.

Fitore Pacolli, theksoi se nuk u informuan mbi kontratat e ligjshme të lobimit, për të cilat tha se mund të informohen edhe përmes raportit me shkrim lidhur me ato dhe për buxhetin.

Vjosa Osmani-Sadriu, pyeti ministrin lidhur me nënshkrimin e kontratës për Interpolin në lartësi prej 1,2 milion euro, se kush e ka nënshkruar dhe se a i ka kaluar procedurat e ligjshme ajo kontratë. Më tej, ajo tha se do të bëhet një kërkesë me shkrim për të gjitha kontratat që janë në dispozicion në MPJ, që kanë të bëjnë me lobim dhe njohje nga viti 2010.

Behgjet Pacolli, tha se lidhur me kontratat, do të sjellë raport me shkrim, ndërsa kontrata për Interpol nuk është nënshkruar nga MPJ-ja.

Glauk Konjufca, tha se anëtarësimi në organizata ndërkombëtare është çështje shumë e rëndësishme për Kosovën që të jetë pjesë e tyre, me theks të veçantë në Interpol dhe në Këshillin e Evropës. Në lidhje me procesin e anëtarësimit të Kosovës në Interpol, tha se ka qenë një dobësi e mekanizmave kompetentë, që kanë qenë të përfshirë në këtë proces. Është dashur të punohet me secilin shtet veç e veç, për të pasur një pasqyrë të përafërt, lidhur me mundësinë e anëtarësimit.

Për deklaratat e zyrtarëve se puna është e kryer për anëtarësim, tha se dikush duhet të mbajë përgjegjësinë. Lidhur me këtë dështim, tha se ekzistojnë dy aspekte, dështimi i krijimit të pasqyrës objektive të votave të sakta që i kemi ose ka qenë pasqyra e saktë por nuk kemi dashur të tregojmë.

Behgjet Pacolli, sa i përket procesit të anëtarësimit në Interpol, tha se çdo bartës i institucioneve të Kosovës është në njëfarë mënyre përgjegjës. Ai shtoi se në këtë drejtim është bërë një punë e madhe dhe se ai asnjëherë nuk ka deklaruar se do të jemi anëtarë të Interpolit, porse Kosova meriton të jetë anëtare. Politikat e lotimit, tha se i ka definuar MPB-ja, ndërsa MPJ-ja asnjëherë nuk është tërhequr nga ndihma në logjistikë dhe me përfaqësitë diplomatike. Është bërë një analizë e votave pas shprehjes së qëndrimeve të përfaqësuesve të shteteve, se është diskutuar vota për secilin shtet, por kanë çaluar disa vota të shteteve të vogla në momentin e fundit, të cilat kanë vepruar në mënyrë autonome si institucione, e jo si shtete. Sigurisht, tha se nuk kemi arritur të perfeksionojmë punën dhe t'i sigurojmë edhe ato çalime që i kemi pasur në momentin e fundit prej disa shteteve.

Vjosa Osmani- Sadriu, tha se duke pasur parasysh se ne duhet të aplikojmë sërish në Interpol, duhet ta marrim me shumë seriozitet votën e Japonisë e Hungarisë dhe pyeti, cili është problemi i votës së Japonisë meqë është një situatë e ngjashme me UNESCO-n dhe a mund të ketë ndikuar deklarata e presidentit se do të hap zyrën në Jerusalem negativisht, tek Emiratet e Bashkuara dhe tek disa shtete si Emiratet.

Behgjet Pacolli, theksoi se ai në cilësi të ministrit shpreh mendimin e unifikuar, dhe se ka pasur befasi nga vota e Malajzisë si një shtet mbështetës i Kosovës. Ndërsa përgjigjja nga Emiratet dhe Japonia për votën e tyre në Interpol, ka qenë se kanë interesa ekonomike me Serbinë, tha ministri. Pos tjerash, ministri tha se nuk do të tërhiqet nga aspirata e të qenit të Kosovës anëtare e Interpolit dhe se do ta udhëheqë task forcën me këtë rast. Qasjen për këtë, tha se do ta përgatisin dhe do ta diskutojnë me KPJDIS-në, para se t'ia propozojnë Qeverisë.

Elmi Reçica, njoftoi se ishte përfaqësues nga komisioni në grupin punues për Interpolin dhe se duke pasur parasysh se më parë është biseduar shumë për UNESCO-n, në njëfarë mënyre i kanë mobilizuar vendet që kanë qenë kundër anëtarësimit të Kosovës dhe është menduar të punohet pa zhurmë të madhe. Është biseduar për secilin shtet veç e veç, por ne si Kosovë nuk e kemi fuqinë e anëtarësimit në organizata ndërkombëtare, e nuk e kanë as shtete e tjera dhe kanë nevojë për aleatë. Beteja tha se ka qenë e ashpër dhe nuk ka qenë vetëm mes nesh e Serbisë, por edhe e mbështetësve tanë dhe të Serbisë. Të gjithë ata që kanë qenë pjesë e angazhimit kanë bërë punë të jashtëzakonshme. Nuk ka pasur neglizhencë e as abstenim të angazhimit e as mungesë të koordinimit politik. Në rastet e tjera të ardhshme, ai propozoi që organizimi të bëhet në forma të tjera dhe parlamenti të jetë i pashmangshëm në këtë aktivitet.

Vjosa Osmani- Sadriu, theksoi se ne i kemi pasur 76 vota për anëtarësim në Interpol, ndërsa Palestina është anëtarësuar me 75 vota vitin e kaluar, që ndoshta ka qenë gabim tërheqja jonë vitin e kaluar sepse ndoshta shtetet e Organizatës së Bashkimit Islamik do të kishin votuar për ne sikurse për Palestinën.

Ajo pyeti ministrin se a ka mundur që çështja e hapjes së temës së kufijve të ndikojë negativisht me 2-3 shtete, që vota e tyre të shkojë nga për, në abstenim, sepse kemi dëgjuar disa deklarata në media se ju, nuk e përjashtoni mundësinë që kjo temë të hapet nëpërmjet korigjimit të kufirit apo diç tjetër. Po ashtu, ajo pyeti ministrin se kur është pyetur nga shtetet e tjera lidhur me debatin e kufijve si kryediplomat, cili ka qenë qëndrimi që ka mbajtur në emër të Kosovës.

Behgjet Pacolli, theksoi se nuk beson se ideja e ndërrimit të kufijve ka ndikuar në votat në Interpol, por dialogu sigurisht se është marrë për bazë, ndikimi i serbeve tek shtetet e tjera kundër nesh, duke ju dhënë dëshmi se jemi duke biseduar me Kosovën. Më tej, ai njoftoi se ka thënë se, nuk ka temë për ndryshimin e kufijve në tavolinë të bisedimeve. Mund të jetë një prej opsioneve ku diskutohet por mund të mos vijë fare në rend dite për diskutim, tha ministri. Temat e dialogut tha se nuk janë ridefinuar ende, por sigurisht presidenti flet për një kontratë të paqes e cila do të jetë ligjore, e mundshme për ne, vetëm nëse Serbia e njeh Kosovën. Më tej, ministri tha se askush nuk e dëshiron ndryshimin e pikave kufitare. Kosova është e aftë që të përcaktojë ardhmërinë e saj dhe të definojë çka është e mirë e çka jo. Ne duhet të dialogojmë dhe të mos ndalemi së dialoguari sepse situata gjeopolitike e krijuar sot, nuk lejon mbyllje në vetvete.

Vjosa Osmani –Sadriu, tha se Kuvendi disa herë është shprehur se duhet të dialogojmë, por që kufijtë janë të paprekshëm, të njëjtën e ka konfirmuar edhe kryeministri i vendit dhe presim që edhe ju diplomatët ta mbani këtë qëndrim me të tjerët, që idetë për prekjen e kufijve të jenë të papranueshme.

Fitore Pacolli, në lidhje me diskutimin e ministrit, se nuk ka tema për korrigjimin e kufirit, tha se ne nuk duhet të kemi tema të bisedimeve si shtet, por ne kemi parime dhe qëndrime.

Behgjet Pacolli, theksoi se nga ai asnjëherë nuk është dëgjuar të ketë thënë se kufijtë e Kosovës mund të ndryshojnë, që Kushtetuta të mos respektohet apo se e ka vërë në pyetje 17 shkurtin e 2008. Tani për tani, tha se nuk ka tema dhe posa të ketë harmoni politike brenda institucioneve, atë mund ta përcjellë jashtë.

Vjosa Osmani- Sadriu, tha se nga viti 2012, dialogu ka kaluar nga niveli teknik në nivel të kryeministrave. Kuvendi i Kosovës, qeveri e opozitë kanë votuar një dokument që nuk ka saktësuar se cilat janë temat e dialogut, por ka saktësuar synimin për njohje reciproke dhe i ka përcaktuar se cilat nuk do të jenë temat. Ai dokument e obligon cilëndo qeveri dhe thotë se nuk negociohet integriteti territorial, nuk negociohet rregullimi i brendshëm dhe karakteri unitar i Kosovës.

Elmi Reçica, tha se secili shtet i cili shkon në dialog e di saktë se çka mund të bisedojë dhe çka jo. Nuk besoj, tha ai se dikush mund të ketë mandat të bisedojë përtej rezolutave të miratuara në Kuvend. Lidhur me dialogun, tha se do të hartohet edhe një ligj dhe se nuk ka hapësirë që të bëhet diç përtej përcaktimeve të parapara.

Fitore Pacolli, duke u ndërlidhur me diskutimin se Japonia si vend përkrahës ka abstenuar në votimin për Interpol për shkak të interesave ekonomike që i ka me Serbinë, pyeti ministrin se cila është strategjia e ministrisë për të marrë votën nga Japonia.

Behgjet Pacolli, tha se secili shtet i ka strategjitë e veta, Japonia është një shtet i cili e ka ndihmuar më së shumti Kosovën. Në takim me ambasadorin e Japonisë e kanë diskutuar këtë çështje dhe se ata nuk kanë asgjë kundër Kosovës, por kanë interesat e tyre të tjera. Po ashtu, edhe Emiratet e Bashkuara e kanë ndihmuar Kosovën me investime, por vota e tyre neutrale ishte për arsye se kanë interesa të tjera në Serbi dhe ne duhet t'i kuptojmë ata, tha ministri. Me Hungarinë kemi nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, por vota e tyre ishte neutrale dhe shtoi

se ne duhet të punojmë me këto shtete sepse gjeostrategjitë e tyre janë ato, të cilat vendosin së fundmi.

Vjosa Osmani- Sadriu, lidhur me Japoninë kërkoi që MPJ-ja ta njoftojë ambasadën tonë në Japoni se jemi të interesuar për zhvillim të diplomacisë parlamentare me të, dhe kemi shpreh interesim që të organizohet një vizitë në Japoni me ç'rast ambasada jonë duhet të angazhohet intenzivisht.

Behgjet Pacolli, kërkoi nga komisioni që të organizohen disa takime të përbashkëta joformale për shkak të disa çështjeve dhe informatave të cilat duhet të diskutohen.

Vjosa Osmani- Sadriu, theksoi se presim nga zyra e ministrit t'na informojë se kurdo që ministri ka kohë të organizohet një takim joformal koordinues, për vizita dhe për koordinim të aktiviteteve. Kërkoi nga ministri që në punën rreth strategjisë të MPJ-së të përfshihen deputetët e po ashtu edhe për Këshillin e Evropës, e grupet e tjera.

Behgjet Pacolli, lidhur me shkresën për të cilën tha se e ka marrë nga komisioni, në të cilën thuhet se 90% e të emëruarve në misione janë politik, deklaroi se nga 44 misione aktive, 31 ambasadave dhe 13 misioneve konsullore, prej tyre 22 misione udhëhiqen nga të emëruar të karrierës.

Vjosa Osmani- Sadriu, theksoi se sa i përket kuotës, ligji në fuqi flet për emërimet që dekretohen nga presidenti dhe nuk flet për të ngarkuar me punë. Ajo tha se për disa çështje të tjera të shërbimit diplomatik do të ftohet sërish ministri.

Në përfundim të takimit znj. Osmani, tha se të ngarkuarit me punë nuk mund të numërohen në kuotë dhe kërkoi që të respektohet ky kriter. Njëkohësisht, ajo kërkoi nga MPJ-ja që propozimet e bëra të dekretohen sa më shpejt, duke u shprehur se komisioni vlerëson se a janë kandidatët diplomat karriere apo të emëruar politik, në mënyrë që të respektohet ligji.

Mbledhja përfundoi në orën 17:15.

Kryetarja e Komisionit,

Vjosa Osmani-Sadriu

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.